

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi, falsifikuan dokumentet për 6 prona
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/arrestohen-ish-drejtori-i-ashk-se-dhe-perfituesi-falsifi-kuan-dokumentet-per-6-prona/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 09:20:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 09:16:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	432ab19c1fbeafe85042317eb2aa8a7af733a184f4010d10969b3c50e8e7ac6f
TEKSTI	59517d24f3f2bfd6f5e19aa9a57e8234f57dd2cf888e255436809e6b0a64fb13
PAMJA	19394f5533f49bf7675765b0c51c25a028e64351e505f155780192a0b788da4a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4ae55e7868c41c43e73e7caf12025f0fe809012c76bc9c8b7c7fb54aed43d7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	34a49f1fb4e3ec12662634f6e1a4b8d33a530968e91968fa2be08bb537c32d65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4ae55e7868c41c43e73e7caf12025f0fe809012c76bc9c8b7c7fb54aed43d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi, falsifikuan dokumentet për 6 prona

AKTUALITET E SHTUNË, 19 SHTATOR 2026 11:16



Ish-drejtori i ASHK në Fier dhe një përfitues janë vënë në prangat e policisë, pasi dyshohen për përfitimin dhe regjistrimin e paligjshëm të 6 pronave me sipërfaqe rreth 71.7 hektarë në zonën e Levanit dhe Dermënasit. Ndërsa për ish-hartografin e ASHK-së, është vendosur masa "Detyrim paraqitje".

Sipas hetimeve, përfituesi me iniciale E. H. dyshohet se ka regjistruar pronat duke përdorur dokumentacion të falsifikuar, pavarësisht se kishte përfituar më herët kompensim financiar prej 53.8 milionë lekësh për të njëjtën çështje. Pas regjistrimit, një pjesë e pasurive dyshohet se janë shitur, duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme.



Gjatë hetimit janë sekuestruar 715.976 euro në një llogari bankare të këtij shtetasi si dhe dokumente dhe pajisje elektronike. Prokuroria po vijon hetimet për falsifikim dokumentesh, mashtrim, pastrim parash dhe shpërdorim detyre.



Njoftimi i Prokurorisë Fier

Falsifikoi dokumentet për 6 prona me ndihmën e ish-drejtorit të ASHK-së, Prokuroria e Fierit jep masën e sigurimit 'Arrest me burg' për dy personat nën hetim, masë edhe për topografin

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, u arrestuan shtetasit, E.S., ish-Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe përfituesi i pronave, të dyshuara të marra me dokumente të falsifikuara E.H., si dhe u dha masë sigurimi 'Detyrim për t'u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore' për shtetasin E.R., ish-hartograf pranë ASHK-së Fier.

Hetimet mbi procedimin penal nr. 1715, datë 05.11.2025, për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Mashtrimi", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar respektivisht nga nenet 186, 143, 287 dhe 248 të Kodit Penal, nënën pas dyshimeve për përfitim dhe regjistrim të kundërligjshëm të pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit, si dhe tjetërsimin e tyre dhe qarkullimin e vlerave monetare të përfituara.

Fakti penal i dyshuar lidhet me vendimin e vitit 2008 i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që parashikonte njohjen e të drejtës së kompensimit për 100 ha tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dermënasit. Një prej trashëgimtarëve përfitues, shtetasi E.H., ka përfituar më pas, me Vendimin nr. 1944, datë 26.11.2018, të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, kompensim financiar në vlerën 53.800.000 lekë.

LAJMET KRYESORE



4 ndeshje në Nations League, Maran grumbullon 29 lojtarë. Del lista zyrtare




Presidentja e KE-së rikthehet në Shqipëri, Von der Leyen lë jashtë agjendës Serbinë



Dorëzohet Danimarka/SHBA-ja, Groenlanda drejt marrëveshjes historike. Fiton Trump



Takimi i përjavshëm i "Pranisë Besnike", Rama publikon pamjet: Ju uroj një fundjavë të mbarë



Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?

TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

MË TË LEXUARAT

Pavarësisht kompensimit financiar, nga hetimi dyshohet se gjatë vitit 2023, shtetasi E.H. ka ndjekur procedura për regjistrimin e 6 pasurive në ZK nr. 2436, me sipërfaqe totale rreth 71.7 ha, duke iu referuar Vendimit nr. 246, datë 21.02.2008. Hetimi deri në këtë fazë ka evidentuar veprimet e E.S., ish-Drejtor i ASHK Fier, dhe E.R., ish-hartografi pranë ASHK Fier, lidhur me trajtimin administrativ dhe kadastral të dokumentacionit të përdorur për regjistrimin e pasurive.

Pas regjistrimit, disa prej pasurive dyshohet se janë tjetërsuar nëpërmjet shitjes, duke gjeneruar të ardhura në vlera të konsiderueshme. Hetimi vijon për verifikimin e këtyre transaksioneve, gjurmimin e vlerave monetare dhe përcaktimin e destinacionit të tyre.

Gjatë hetimit u sekuestruan edhe 715.976 euro, të depozituar në llogarinë bankare të E.H. Si dhe janë sekuestruar dokumente, pajisje elektronike dhe materiale të tjera, të cilat do t'i nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme. Hetimi vijon për dokumentimin e plotë të rrethanave të çështjes, identifikimin e personave të tjerë të mundshëm të përfshirë dhe individualizimin e përgjegjësive penale.

ETIKETA FIER

MË SHUMË NGA AKTUALITETI

Protestë në Vlorë kundër ndërtimit të muzeut hebraik



Ndërrhyrja në Aeroportin e Vlorës është ndërrhyrja më mafioze që mund t...

Presidentja e KE-së rikthehet në Shqipëri, Von der Leyen lë jashtë ag...



Kursi i këmbimit, 19 shtator 2026

Aksi Kashar-Vaqar nis të lirohet, IKMT ndërhyn në objektet në gjurmën...



Maratona "Little Paris" në Korçë, akset ku kufizohet qarkullimi

LAJMET E FUNDIT



Arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi, falsifikuan dokumentet për 6 prona

[4 MINUTA MË PARË](#)



Tabaku akuzon qeverinë: Familjet marrin borxh, paratë publike shkojnë te të afërmit e pushtetit

[6 MINUTA MË PARË](#)



4 ndeshje në Nations League, Maran grumbullon 29 lojtarë. Del lista zyrtare

[13 MINUTA MË PARË](#)



Bordi i Transparencës vendos çmimet e reja të naftës dhe benzinës



Protestë në Vlorë kundër ndërtimit të muzeut hebraik

[45 MINUTA MË PARË](#)



VIDEO/ Kujdesi dentar në zonat rurale, ministrja Spahiu: Depistime edhe për fëmijët me

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Koha Jone

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.